



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 280/1 prot.

Elbasan, me 04.11.2022

VENDIM

Nr. 31 datë 04.11.2022

Për

përcaktimin e pagave në nivelin e kufirit minimal dhe kufirit maksimal (pozicione pune në detyrë) në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM-n nr. 647, datë 05.10.2022 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë', i ndryshuar", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 05, datë 17.02.2021 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2022", Vendimi i Senatit Akademik nr. 22, datë 03.11.2022 "Për përcaktimin e pagave në nivelin e kufirit minimal dhe kufirit maksimal (pozicione pune në detyrë) në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", VBA Nr. 7 datë 09.03.2022 "Për miratimin e planbuxhetit të vitit 2022", i ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.11.2022

VENDOSI:

- Miratimin në nivelin e kufirit minimal dhe kufirit maksimal (pozicione pune në detyrë) në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për:
 - Pozicioni Dekan nga kategoria "Docent"/ "Doktor", të paguhet me pozicionin Dekan nga kategoria "Profesor"/ "Profesor i asociuar" - Kufiri minimal në vlerën 141,500 lekë - Kufiri maksimal në vlerën 152,000 lekë
 - Pozicioni Lektorë "Docent" nga "Doktor", të paguhet me pozicionin Lektorë - Kufiri minimal në vlerën 96,700 lekë - Kufiri maksimal në vlerën 103,850 lekë
 - Pozicioni Lektorë "Docent" nga "Msc", të paguhet me pozicionin Lektorë - Kufiri minimal në vlerën 96,700 lekë - Kufiri maksimal në vlerën 103,850 lekë
- Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi

